<b>MM</b>	Memorandum Mirëkuptimi
<b>NE</b>	Skema e Ndhmës Ekonomike
<b>OJF</b>	Organizatat Jofitimprurëse
<b>QSM</b>	Qendra Sociale Murialdo
<b>AFP</b>	Aftësimi dhe Formimi Profesional

### Përmbledhje e projektit

Ky raport mbi praktikat më të mira është zhvilluar për projektin e financuar nga BE-ja me titull “Modeli i qëndrueshëm i shërbimeve të integruara të punësimit dhe kujdesit social në Bashkinë e Mallakastrës”. Ky projekt është zbatuar në Bashkinë e Mallakastrës nga Bashkia Mallakastër në partneritet me Help në Shqipëri dhe QSM. Faza e zbatimit të projektit filloi më 1 janar 2023 dhe përfundon më 28 shkurt 2025. Buxheti i përgjithshëm i projektit ishte 222,222 € (dyqind e njëzet e dy mijë e dyqind e njëzet e dy euro). Projekti është financuar nga BE-ja si pjesë e mekanizmit disavjeçar të financimit IPA dhe bashkëfinancuar me fondet e siguruara nga Help në Shqipëri nga Aktion Deutschland Hilft dhe Ministria e Jashtme Federale Gjermane.

### Konteksti i projektit

Bashkia e Mallakastrës ndodhet në Qarkun e Fierit në Shqipërinë qendrore. Mallakastra është një bashki e vogël dhe kryesisht rurale. Është një territor i largët për shkak të infrastrukturës së dobët rrugore brenda dhe jashtë bashkisë. Është një zonë me depresion ekonomik, e cila ka parë një rënie të ndjeshme në industrinë e nxjerrjes dhe përpunimit të naftës gjatë dekadës së fundit, dikur punë-ofruesi kryesor vendas dhe shtylla kryesore e ekonomisë lokale.

Bashkia Mallakastër, ashtu si pjesa tjetër e Shqipërisë, ka përjetuar ndryshime të konsiderueshme demografike gjatë tre dekadave të fundit që nga fundi i komunizmit. Plani Social Vendor i bashkisë shkruan “Papunësia e lartë dhe kushtet e vështira ekonomike kanë sjellë një valë të madhe migrimi në qytetet kryesore dhe migrimin ndërkombëtar”.<sup>1</sup> Popullsia lokale është zvogëluar vazhdimisht pasi shumë banorë lokalë janë larguar nga bashkia. Ndërmjet viteve 2022 dhe 2023 ka pasur një rënie prej 1,555 banorë vendas, kryesisht fëmijë dhe të moshuar.<sup>2</sup>

Për sa i përket **punësimit**, normat e papunësisë në Mallakastër kanë qenë të larta prej kohësh dhe papunësia ka prekur veçanërisht të rinjtë dhe gratë. Rinia<sup>3</sup> ka probleme me kalimin nga arsimi në fuqinë punëtore dhe shumë prej tyre nuk kanë kërkuar të aftësohen profesionalisht për të patur më shumë mundësi në punësim. Gratë e papuna mund të kufizohen gjithnjë e më shumë në shtëpitë e tyre dhe të izoloohen nga shoqëria. Shërbime të punësimit dhe shërbimet e AFP-së nuk janë ofruar ndonjëherë në bashki.<sup>4</sup>

Në Planin Social Vendor të Bashkisë 2024-2027 thuhet “Mungesa e vendeve të punës ka orientuar familjet në Bashkinë Mallakastrës drejt skemës së mbështetjes sociale” dhe në vitin 2023 para hapjes së QKSHF-së ishin 375 familje të mbështetura nga skema e NE. Prioritet ishte mbështetja e familjeve me 3, 4 dhe 5 anëtarë.<sup>5</sup> Bashkia përballlet me shumë

<sup>1</sup>Bashkia Mallakastër Plani Social Vendor 2024-2027, faqe 3, Bashkia Mallakastër, 2024

<sup>2</sup>Bashkia Mallakastër Plani Social Vendor 2024-2027, faqe 6-7, Bashkia Mallakastër, 2024

<sup>3</sup>Ligji Kombëtar për Rininë e vitit 2019 e përcakton rininë si një individ, femër apo mashkull, të moshës 15-29 vjeç.

<sup>4</sup>Bashkia Mallakastër Plani Social Vendor 2024-2027, faqe 11, Bashkia Mallakastër, 2024

<sup>5</sup>Bashkia Mallakastër Plani Social Vendor 2024-2027, faqe 9, Bashkia Mallakastër, 2024

sfida socio-ekonomike për shkak të niveleve të larta të varfërisë dhe numrit të lartë të personave që janë në rrezik të lartë të përjashtimit shoqëror.

Për sa i përket **ofrimit të kujdesit shoqëror**, përmirësimi i ofrimit të shërbimeve vendore, duke përfshirë decentralizimin e shërbimeve shoqërore në bashki, është një prioritet i vazhdueshëm i Qeverisë së Shqipërisë. Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” përcaktoi detyrën statutores të bashkive për të ofruar shërbime të kujdesit shoqëror dhe Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit social në Republikën e Shqipërisë” parashikonte ofrimin e shërbimeve shumëfunktionale në bashki me bazë komunitare për të plotësuar nevojat e popullatës vendase, veçanërisht grupeve më të cënueshme. Modeli i Qendrave Komunitare Shumëfunktionale<sup>6</sup> është zhvilluar gjatë dekadës së fundit dhe njihet si modeli më efektiv për ofrimin e shërbimeve vendore për individët dhe familjet e cënueshëm. Shumë bashki të vogla dhe të largëta ende nuk kanë kapacitet infrastrukturor për të ofruar shërbime të tilla në nivel vendor. Para vitit 2023, Bashkia Mallakastër nuk kishte asnjë infrastrukturë të kujdesit shoqëror për grupet vulnerabël. Projekti i në Mallakastër ka mbështetur rinovimin e disa ambienteve të bashkisë me qëllim hapjen e një QKSHF-je që ofron shërbime vendore të kujdesit shoqëror dhe mbështetjes së punësimit.

#### Korniza logjike e projektit

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është të kontribuojë në **përfshirjen shoqërore të grupeve të cënueshme në Shqipëri nëpërmjet punësimit dhe kujdesit shoqëror**. Projekti synoi ta arrinte këtë në dy drejtime duke përmirësuar mundësitë ekonomike të të rinjve dhe grave nëpërmjet punësimit dhe duke përmirësuar aksesin e grupeve të cënueshme në shërbimet shoqërore në Mallakastër. Kapacitetet e Bashkisë Mallakastër për të mbështetur grupet e cënueshme do të rriteshin duke krijuar qendrën e parë komunitare shumëfunktionale të bashkisë, të mbështetur nga komuniteti dhe me staf vendas të aftësuar për të ofruar shërbime të integruara të kujdesit shoqëror dhe të punësimit. Nëpërmjet programeve të synuara dhe të përshtatura për individët e papunë do të përmirësoheshin aftësitë profesionale të nevojshme për të hyrë në tregun e punës, gratë e papuna do të ishin në gjendje të hapnin dhe drejtonin një biznes social dhe individët e vetëpunësuar do të merrnin mbështetje për bizneset ose feramat e tyre të vogla. Grupet e cënueshme në Mallakastër do të mbështeteshin me një paketë shërbimesh të kujdesit shoqëror të ofruara në QKSHF dhe në komunitet.

#### Grupet e synuara të projektit

Grupi kryesor i synuar që projekti ka mbështetur janë **individët dhe familjet e cënueshme** në Mallakastër që kanë nevojë për akses në shërbimet e kujdesit shoqëror për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre. Projekti ka patur si fokus të papunët që kanë nevojë për mbështetje për të hyrë në tregun e punës. **Gratë dhe të rinjtë** si dy grupe me më shumë gjasa të jenë të papunë dhe ekonomikisht joaktivë, kanë nevoja që lidhen me aftësimin profesional si kurset profesionale dhe formimin profesional në vendin e punës për t'i përgatitur për punësim. Të rinjtë që do të largohen nga arsimit gjithashtu kanë nevojë për mbështetje me këshillim për karrierë.

---

<sup>6</sup>MSHMS vendosi standarde kombëtare për Qendrat Komunitare Shumëfunktionale në 2019

Stafi i QKSHF-së dhe sektori i shërbimeve shoqërore në bashki janë grupi i dytë i synuar i mbështetur nga projekti. Duke qenë se QKSHF-ja në Ballsh është e para që ngrihet në bashki, stafi i QKSHF-së dhe stafi i shërbimeve shoqërore në bashki kishin nevojë për trajnime mbi modelin e QKSHF-së dhe standardet e funksionimit. Gjithashtu gjatë zbatimit të projektit ata kishin nevojë të vazhdueshme për mbështetje për të ndërtuar përvojën dhe ekspertizën e tyre në ofrimin e shërbimeve cilësore të kujdesit shoqëror.

## Praktikat më të mira në nivel projekti

Praktikat më të mira të identifikuara në projektin e Mallakastrës janë paraqitur nën tre shtyllat e projektit.

### 1. Avancimi i kapaciteteve institucionale dhe teknike për të mbështetur grupet e cënueshme

Shtylla e parë e projektit ishte rritja e aftësive dhe kapaciteteve të Bashkisë Mallakastër për të mbështetur grupet në rrezik. Kjo u realizua përmes dy komponentëve të mëposhtëm:

- Zhvillimi i kapaciteteve institucionale nëpërmjet krijimit të një QKSHF-je në Ballsh që ofron shërbime të integruara të kujdesit shoqëror dhe mbështetjes së punësimin për grupet në rrezik.
- Zhvillimi teknik duke rritur kapacitetet e QKSHF-së dhe duke mbështetur profesionistët e kujdesit shoqëror për të ofruar dhe menaxhuar ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Praktikat më të mira të identifikuara në këtë shtyllë të projektit janë:

- Modeli i angazhimit të komunitetit
- Ngritja e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve të integruara shoqërore
- Ngritja e partneriteteve për ndikim shoqëror



## 1.1. Modeli i angazhimit të komunitetit

Modeli i angazhimit të komunitetit qëndron si një praktikë e mirë në sigurimin e përfshirjes shoqërore, planifikimit të pjesëmarrjes në shërbime dhe zhvillimit të qëndrueshëm lokal. Duke përfshirë në mënyrë aktive komunitetin në çdo fazë, projekti jo vetëm që ofroi shërbime, por gjithashtu transformoi perceptimet, ndërtoi besimin dhe po nxiti ndryshime sociale afatgjata.

### Pse kjo është një praktikë e mirë?

Ngritja e QKSHF-së prezantoi një model të ri të angazhimit komunitar në Mallakastër dhe siguroi që nevojat e komunitetit lokal të ishin në qendër të ofrimit të shërbimeve duke:

- **Prioritizuar përfshirjen e komunitetit** nga faza e konceptimit deri në fazën e zbatimit;
- **Adresuar skepticizmin dhe mosbesimin** duke përfshirë në mënyrë aktive palët e interesuara lokale;
- **Përdorur planifikimin e bazuar në dëshmi** me kryerjen e një vlerësimi të gjerë të nevojave;
- **Krijuar një mekanizëm të strukturuar këshillues për komunitetin** për konsultime të vazhdueshme.

### Elementet kryesore

- **Vlerësimi gjithëpërfshirës i nevojave**

Është kryer një vlerësim i nevojave duke përfshirë komunitetin lokal. Mbi 300 familje u konsultuan përmes intervistave dhe pyetësorëve në Ballsh dhe fshatrat përreth.

Një fokus grup i ofruesve të shërbimeve lokale, duke përfshirë stafin e departamentit të shërbimit social dhe AKPA-në e Mallakastrës, duke identifikuar boshllëqet në shërbimet socio-ekonomike për komunitetin vendas gjë që ndikoi më pas që QKSHF të fokusonte veprimtarinë e saj veçanërisht në përmbushjen e nevojave të grupeve në rrezik me më shumë cilësi dhe efektivitet.

### Gjetjet kryesore nga vlerësimi i nevojave ishin:

Vlerësimi i nevojave nxori në pah **disa gjetje kryesore**:

- **70% e familjeve të synuara** kishin 5 ose më shumë anëtarë.
- **85% e të anketuarve** e konsideronin papunësinë si problemin kryesor, ndërsa migrimi ishte një tjetër sfidë e rëndësishme për këtë bashki.
- **Shumë të anketuar** deklaruan që ishin të angazhuar në aktivitete ekonomike informale për të përmbushur nevojat e familjes.
- **Vetëm 20% e atyre që kishin kërkuar mbështetjen e shtetit e kishin marrë atë**, kryesisht përmes skemave financiare të mbrojtjes sociale.
- **90% e qytetarëve të anketuar** kërkonin më shumë shërbime për arsimimin e fëmijëve të tyre dhe mbështetje më të madhe për punësim.
- **Ndërtimi i besimit në komunitet**

Para zbatimit të këtij projekti, nuk kishte përvojë në ofrimin e shërbimeve të kujdesit social dhe punësimin për qytetarët vendas. Për këtë arsye, komuniteti ishte skeptik dhe nuk besonte se shërbimet e QKSHF-së do të kishin ndikim pozitiv në jetën e tyre. Përfshirja aktive e komunitetit që në fazën e planifikimit të projektit ndihmoi në krijimin e besimit dhe ndjenjës së pronësisë lokale. Gjithashtu, komunikimi transparent mbi misionin dhe shërbimet e QKSHF luajti një rol kyç në ndryshimin e perceptimeve dhe rritjen e angazhimit të komunitetit.

## Ndikimi

- ✓ Rritja e pjesëmarrjes së komunitetit – Më shumë qytetarë vendas u angazhuan në diskutime mbi shërbimet lokale, duke forcuar dialogun dhe bashkëpunimin.
- ✓ Përmirësimi i aksesit në shërbime – Shërbimet u përshtatën më mirë me nevojat e komunitetit, duke i bërë ato më të prekshme dhe efektive.
- ✓ Fuqizimi i komunitetit për një pronësi të qëndrueshme – Palët e interesuara në Bashkinë Mallakastër u përfshinë në bashkë-menaxhimin e zgjidhjeve, duke garantuar vijimësinë e ndërhyrjeve.
- ✓ Qasje e shkallëzueshme dhe e përsëritshme – Modeli i aplikuar mund të përshtatet dhe zbatohet edhe në Bashki të tjera me sfida të ngjashme socio-ekonomike.

## 1.2. Ngritja e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve të integruara

Qasjet e ndërtimit të kapaciteteve të ndërrmarra gjatë projektit po sigurojnë që modeli i ri i ofrimit të shërbimeve në QKFSH Mallakastër të jetë i integruar dhe i qëndrueshëm.

### **Pse kjo është një praktikë më e mire?**

Programi i ngritjes së kapaciteteve për stafin e QKFSH-së dhe stafin e Seksionit të Shërbimeve Sociale është një praktikë e mirë sepse adresoi mungesën e njohurive dhe përvojës paraprake në ofrimin e shërbimeve të integruara në nivel bashkiak. Kjo u arrit përmes:

- **Trajnimeve praktike të strukturuar** – Një kombinim efektiv i teorisë me praktikën për të forcuar aftësitë e stafit.
- **Qasjes mentoruese** – Mbështetje e drejtpërdrejtë për transferimin e njohurive dhe ndërtimin e përvojës, duke krijuar besim dhe siguri profesionale. Elementet kryesore të programit
- **Trajnim fillestar gjithëpërfshirës**  
Një punëtori hyrëse tre-ditore mbuloi aspektet teorike, duke përfshirë gjetjet e vlerësimit të nevojave, standardet e funksionimit të QKSHF-së dhe procedurat e menaxhimit të rasteve.
- **Ekspozimi praktik**  
Një vizitë studimore në QKSHF Fier i dha stafit të QKSHF-së Mallakastër mundësinë të mësonte nga një qendër operationale me përvojë të suksesshme në ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjen e punësimit.
- **Ofrimi i mbështetjes së vazhdueshme**  
Stafi i QKFSH-së përfitoi trajnime dhe mentorime të vazhdueshme përmes vizitave në terren dhe udhëzimeve online, duke siguruar zbatimin efektiv të shërbimeve.

Institucionalizimi

Nevoja për zhvillim të vazhdueshëm profesional është njohur zyrtarisht në Planin Social Lokal të Bashkisë 2024-2027, duke siguruar qëndrueshmërinë e përpjekjeve të ngritjes së kapaciteteve.

## Ndikimi

- ✓ Zbatimi efektiv i njohurive në praktikë – Qasjet e ngritjes së kapaciteteve u mundësuan stafit të QKFSH-së të zbatojë teorinë në praktikë, duke forcuar besimin dhe ekspertizën lokale në ofrimin e shërbimeve të integruara.
- ✓ Model i përsëritshëm dhe i shkallëzueshëm – Vizitat studimore dhe mentorimi mund të aplikohen në Bashki të tjera ku po apo do të ngrihen QKFSH të reja.
- ✓ Qëndrueshmëri dhe zhvillim afatgjatë – Integrimi i ngritjes së kapaciteteve në strategjitë në nivel bashkie siguron që personeli i trajnuar të vazhdojë të zhvillohet dhe të mbetet i angazhuar në periudhë më afatgjatë.

### 1.3. Partneritete bashkëpunuese për ndikim social

Nxitja e marrëdhënieve të forta mes institucioneve publike dhe shoqërisë civile ka qenë një nga aspektet kryesore të këtij projekti, duke e kthyer këtë partneritet bashkëpunues si një praktikë e mire dhe efektive.

#### **Pse kjo është një praktikë më e mirë?**

Ky projekt krijoi me sukses bashkëpunim shumë-sektorial duke forcuar partneritetet **publike-civile-private**. Kjo qasje mundësoi një ndikim më të madh social për qytetarët vendas në Mallakastër dhe siguroi që programet e ndryshme të kishin një ndikim të qëndrueshëm.

Elementet kryesore të bashkëpunimit

- **Angazhimi inovativ me shoqërinë civile**

Më parë, në Mallakastër kishte një prani minimale të shoqërisë civile dhe asnjë përfshirje të OShC-ve në ofrimin e shërbimeve. Nëpërmjet mekanizmave të bashkëpunimit, ky projekt mundësoi një partneritet efektiv dhe të qëndrueshëm mes Bashkisë Mallakastër dhe dy OShC-ve.

- **Bashkëpunimi publik-privat**

Bashkia dhe OShC-të partnere zhvilluan shërbime mbështetëse për punësimin në QKSHF, duke përfshirë aktivisht bizneset lokale për të krijuar më shumë mundësi për komunitetin për punësim.

## Ndikimi

- ✓ **Ndërtimi i një bashkëpunimi të qëndrueshëm** – Partneritetet e krijuara gjatë projektit kanë hedhur bazat për zgjerimin e ardhshëm të programit të QKFSH-së.
- ✓ **Zgjerimi i rolit të OShC-ve në ofrimin e shërbimeve** – Përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit, angazhimi efektiv i OShC-ve është i mundur edhe në ato Bashki me një prani të kufizuar të shoqërisë civile.



## 2. Përmirësimi i qasjes në mundësitë ekonomike për gratë dhe të rinjtë e papunë

Shtylla e dytë e projektit u përqendrua në forcimin e aftësisë së Bashkisë Mallakastër për të rritur mundësitë ekonomike për gratë dhe të rinjtë e papunë. Kjo u realizua përmes dy komponentëve kryesorë:

- **Shërbimet mbështetëse të punësimit** duke përfshirë këshillimin e karrierës për studentët, mbështetjen për arsimin dhe formimin profesional (AFP) dhe një skemë trajnimi në vendin e punës për gratë dhe të rinjtë e papunë.
- **Shërbimet mbështetëse për biznesin**, të fokusuar në ndërtimin e kapaciteteve sipërmarrëse, një skemë granti për bizneset e reja dhe mbështetjen për gratë e papuna për të ngritur dhe menaxhuar një biznes social.

Praktikat më të mira të identifikuara në këtë shtyllë të projektit përfshijnë:

- Modelin e këshillimit të karrierës për nxënësit e shkollave.
- Nismat aktive të tregut të punës për të rinjtë e papunë.
- Modelin e mbështetjes së biznesit për bizneset e vogla dhe fermat

## 2.1 Modeli i këshillimit të karrierës për nxënësit e shkollave

**Pse kjo është një praktikë e mirë?**

Ky model konsiderohet një praktikë e mirë sepse:

- **Ndihmon nxënësit në kalimin nga arsimi në tregun e punës**, duke i orientuar drejt mundësive të përshtatshme për punësim.



### Elementet kryesore

- **Shërbimi i dedikuar për të rinjtë**  
QKSHF Mallakastër krijoi një shërbim këshillimi për karrierën si pjesë integrale e mbështetjes për punësimin, duke synuar nxënësit në vitin e fundit të shkollës 9-vjeçare dhe nxënësit e shkollës së mesme.
- **Bashkëpunimi me shkollat lokale**  
Stafi i QKFSH-së krijoi lidhje me shkollat në Ballsh dhe organizoi **seanca këshillimi me nxënës të moshave të ndryshme**, duke përdorur qasje gjithëpërfshirëse që adresojnë edhe çështje gjinore në hyrjen në tregun e punës.
- **Institucionalizimi**  
Ky shërbim është tashmë i integruar në **Planin Vendor të Orientimit dhe Këshillimit të Karrierës 2024-2025**, duke siguruar vazhdimësinë e tij.

### Ndikimi

- ✓ QKSHF-ja është njohur nga **Zyra Rajonale e Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar në Mallakastër** si një ofrues kryesor i këshillimit për karrierën.
- ✓ Bashkëpunimi me QKFSH-në është formalizuar dhe roli i saj është zgjeruar, duke përfshirë punën me komunitetin, prindërit dhe bizneset lokale, si dhe organizimin e panairit lokal të karrierës.

## 2.2. Nisma aktive e tregut të punës për të rinjtë e papunë



### Pse kjo është një praktikë e mirë

Skema e e formimit profesional në vendin e punës konsiderohet një praktikë e mirë sepse:

- **Skema** e formimit profesional në vendin e punës është një metodë e dëshmuar për përfshirjen në tregun e punës, veçanërisht për grupet e cënueshme që mund të përballen me barrierat e ndryshme që i pengojnë përpjekjet e tyre që të hyjnë në tregun e punës.
- **Ndihmon** në zhvillimin e aftësive profesionale përmes trajnimeve të strukturuar në bizneset lokale.

### Elementet kryesore

- **Angazhimi i bizneseve vendase**

Përmes kontakteve të vazhdueshme, stafi i QKFSH-së ishte në gjendje të rriste mirëkuptimin dhe angazhimin e bizneseve lokale në nismat aktive të gjetjes së tregut të punës për grupet e cënuara, me fokus të veçantë grata dhe të rinjtë e papunë. Roli i QKFSH-së ishte të ndërmjetësonte zhvillimin e formimit profesional në vendin e punës me bizneset lokale.

### ● **Përzgjedhja e përfituesit**

Përzgjedhja e të rinjve të papunë të synuar është një shembull i qasjeve të integruara të ofrimit të shërbimeve të ndërmarra nga QKSHF. Përzgjedhja e pjesëmarrësve u bazua në **vlerësimin fillestar të nevojave në QKFSH**. Procesi i përputhjes praktikant-biznes u zhvillua **me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) në Mallakastër**. Mbështetja e vazhdueshme e skemës së formimit profesional në vendin e punës siguroi që 100% e praktikantëve të përfundonin me sukses periudhën e tyre të trajnimit.

- ✓ Të rinjtë u njohën me punëdhënësit vendas dhe fituan përvojë praktike.
- ✓ Shtatëdhjetë përqind e të trajnuarve siguruan punësim pas përfundimit të skemës.
- ✓ Të rinjtë pjesëmarrës dhe punëdhënësit vendas e mirëpritën ndërhyrjen dhe bënë thirrje që skema të vazhdojë dhe të zgjerohet.
- ✓ QKSHF-ja dhe Bashkia rritën njohuritë e tyre në konceptimin, zhvillimin dhe zbatimin e një skeme aktive të tregut të punës e cila adreson kërkesat lokale për aftësi.
- ✓ Me financim të mëtjshëm, skema e formimit profesional në vendin e punës mund të përsëritet dhe/ose të shtrihet brenda Bashkisë Mallakastrës dhe më gjerë

## 2.3. Modeli i mbështetjes së biznesit për bizneset e vogla dhe fermat



### **Pse kjo është një praktikë e mirë?**

Programi i mbështetjes së biznesit mund të konsiderohet një praktikë më e mirë sepse:

- **Ofron** një model të avancuar dhe efektiv të mbështetjes për sipërmarrësit lokalë, duke ndihmuar krijimin dhe zgjerimin e bizneseve të reja.

- **Përqëndrohet në vetë-mjaftueshmërinë** e grupeve në rrezik, duke i ndihmuar ata të krijojnë të ardhura të qëndrueshme
- **Kombinon mbështetjen për punësimin dhe sipërmarrjen**, duke përfshirë ngritjen e një biznesi social të drejtuar nga gra të papuna.

### Elementet kryesore

- **Përdorimi i kriterëve socio-ekonomike** për të synuar mbështetjen QKSHF identifikoi dy grupe individësh në nevojë për mbështetje përmes kriterëve socio-ekonomike. Së pari, u identifikuan individë që përballëshin me vështirësi socio-ekonomike që drejtonin biznese të vogla ose kishin ferma të vogla dhe së dyti gratë e papuna që ishin të interesuara për vetëpunësim u zgjodhën për t'u trajnuar dhe mbështetur për të ngritur një biznes lokal me qasje sociale.

### Mbështetja e sipërmarrjes

- **Mbështetje teknike për sipërmarrjen** u ofrua përmes trajnimit për sipërmarrjen dhe mentorimit të individualizuar të biznesit me qëllim mbështetjen e qëndrueshmërisë së biznesit dhe përmirësimit të qëndrueshmërisë së biznesit të vogël ose fermës në ekonominë lokale.

### Mbështetja e biznesit

- **Mekanizmat e financimit** u krijuan duke përfshirë skemën e mbështetjes në pajisje (IGA) për të mbështetur bizneset e vogla dhe fermat për të stimuluar rritjen dhe një grant fillestar për biznesin social të drejtuar nga gratë e papuna.

## Ndikimi

- ✓ Trajnimi i aftësive të sipërmarrjes zgjeroi njohuritë dhe aftësitë e ndërtuara, si dhe ofroi mundësi rrjetëzimi midis bizneseve të vogla dhe fermave.
- ✓ Grantet në pajisje patën ndikime të prekshme, me bizneset që raportuan rritje të klientëve dhe numrit të shërbimeve të ofruara duke rezultuar në rritje të matshme.
- ✓ Si një efekt shumëfishues ka dëshmi të ndikimeve të tjera pozitive, disa biznese të vogla të mbështetura gjithashtu kishin mundur të punësonin punonjës shtesë për shkak të rritjes së numrit të klientëve dhe shërbimeve të ofruara.
- ✓ QKSHF dhe Bashkia kanë rritur njohuritë e tyre në konceptimin, zhvillimin dhe zbatimin e iniciativave mbështetëse të biznesit që adresojnë nevojat e bizneseve lokale dhe fermave të vogla.
- ✓ Nisma për mbështetjen e sipërmarrjes mund të përsëritet dhe/ose të shtrihet brenda Bashkisë Mallakastrës dhe më gjerë në bashki të tjera.

### 3. Avancimi i kujdesit social të integruar për familjet në rrezik

Shtylla e tretë e projektit ishte mbështetja e aftësisë së Bashkisë Mallakastrës për të ofruar kujdes social të integruar për familjet në rrezik. Kjo gjë u avancua përmes komponentit të mëposhtëm:

- **Paketa e shërbimeve të kujdesit social** në QKSHF dhe në komunitet u përqendrua në **shërbimet e menaxhimit të rasteve** duke referuar në shërbime të tjera sociale si **shërbimet e zhvillimit të të rinjve** dhe **shërbimet e mbështetjes së familjes**.

Praktikat më të mira të identifikuar në këtë shtyllë të projektit janë:

- **Qasjet e menaxhimit të rasteve**
- **Programi gjithëpërfshirës i fokusuar te familja**

#### 3.1. Qasjet e menaxhimit të rasteve

**Qasjet e menaxhimit të rasteve** kanë qenë qendrore për modelin shumëfunktional të QKSHF-së që nga konceptimi i tij dhe ka qenë pjesë e brendshme e funksionimit të përditshëm të saj që nga hapja e tij në Shtator 2023.

##### **Pse kjo është një praktikë e mirë?**

Përdorimi i qasjeve të menaxhimit të rasteve në zhvillimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit social në QKSHF Mallakastër është një praktikë më e mirë sepse:

- Siguron që shërbimet e kujdesit social të jenë **të synuara, të individualizuara dhe të qëndrueshme**
- **Adreson dobësi të shumta** brenda familjeve dhe mbështet modelin e integruar të shërbimit të QKSHF
- Mbështet një qasje holistike, të bazuar në besim, e cila fuqizon familjet, nxit angazhimin afatgjatë dhe qëndrueshmëri më të madhe

##### **Elementet kryesore**

- **Përfshirja në operacionet e QKSHF-së**

Qasjet e menaxhimit të rasteve, të cilat janë në përputhje me standardet kombëtare për QKSHF<sup>7</sup>, u inkorporuan si një nga gjashtë standardet bazë të Standardeve të Operimit të QKSHF-së Mallakastër.<sup>8</sup> Menaxhimi i rastit njihet si një përgjegjësi kryesore e stafit të QKSHF-së dhe përfshihet në përshkrimet e tyre të punës. Kjo ka institucionalizuar qasjet e menaxhimit të rasteve brenda Bashkisë.

Teknikat e menaxhimit të rastit duke filluar me identifikimin e rastit janë të përfshira në procedurat fillestare të marrjes/orientimit të QKSHF-së. Pasuar nga shqyrtimi fillestar dhe vlerësimi në QKFSH ose gjatë vizitave familjare në komunitet që çojnë në zhvillimin, zbatimin dhe rishikimin e planeve të veprimit të rasteve individuale ose familjare.

- **Kapaciteti i profesionistëve**

Stafi i QKSHF-së dhe stafi i Departamentit të Shërbimeve Sociale të bashkisë u trajnuan për konceptet dhe praktikat e menaxhimit të rasteve si pjesë e ngritjes së kapaciteteve

<sup>7</sup>Standardet: Shërbimet e Kujdesit Social në Qendrat Komunitare Multidisiplinare, MSHMS, 2019

<sup>8</sup>Udhëzues për QKSHF Mallakastër, Help në Shqipëri, 2023

të tyre fillestare. Mentorimi i vazhdueshëm i mundësoi stafit të QKSHF të zhvillojë përvojën dhe ekspertizën lokale në menaxhimin e rasteve. Kjo ka kontribuar në zhvillimin e vazhdueshëm të praktikës së bazuar në dëshmi në QKSHF dhe brenda Bashkisë.

## Ndikimi

- ✓ Përdoruesit e shërbimeve të QKSHF përshkruan se qasjet e menaxhimit të rasteve ndërtuan besimin dhe fuqizuan individin dhe familjet e tyre
- ✓ Përfituesit kanë nivele të larta kënaqësie me shërbimet e QKSHF dhe e vlerësojnë qasjen e fokusuar te njeriu, duke e konsideruar stafin e QKSHF si “të kuptueshëm” dhe “empatik”. Stafi i QKSHF përdor një qasje pjesëmarrëse me përfituesit e shërbimeve, duke u fokusuar në ndërtimin e një marrëdhënieje bashkëpunimi.
- ✓ Stafi i QKSHF ka një qasje pjesëmarrëse me përdoruesit e shërbimeve, e cila është e përqendruar në ndërtimin e një marrëdhënieje partneriteti
- ✓ Menaxhimi i rasteve është një metodë e dëshmuar e cila mund të standardizohet dhe zgjerohet në bashkitë e tjera që po prezantojnë QKSHF-të.

## 3.2. Programi gjithëpërfshirës i fokusuar te familja



### Pse kjo është një praktikë e mirë?

Programimi gjithëpërfshirës i përqendruar te familja mund të konsiderohet një praktikë e mirë sepse:

- Ofron **mbështetje ndër breznore** e cila u fokusua në forcimin e **zhvillimit të të rinjve dhe qëndrueshmërisë së familjes**
- Ofron një paketë shërbimesh mbështetëse të QKSHF të cilat janë të natyrës parandaluese

## Elementet kryesore

### ● Shërbime të ndryshme të përshtatshme për moshën

QKSHF-ja adresoi nevojat e ndryshme të të rinjve dhe familjeve duke ofruar një sërë mbështetjesh.

- Shërbimet e zhvillimit të ofruara për fëmijët dhe të rinjtë janë fokusuar në edukim, mbështetje psikosociale dhe aktivitete rekreative;
- Shërbimet mbështetëse të familjes në QKSHF ofrojnë shërbime për të rriturit mbi moshën 18 vjeç fokusuar në këshillim dhe mbështetjen e prindërve

### ● Qasja e bazuar në komunitet

Shërbimet e QKSHF u shpërndanë aty ku njerëzit kishin nevojë për to. Kjo nxiti angazhimin afatgjatë dhe krijoi besimin se shërbimet publike plotësojnë nevojat e tyre.

- Për fëmijët, QKSHF kishte një program passhkollor që ofron mbështetje për detyrat e shtëpisë për fëmijët e arsimit fillor dhe një program kampi veror
  - Për të rinjtë, një grup rinor siguroi një hapësirë të sigurt ku mund të kultivohej ndërtimi i besimit dhe mbështetja e dhënë e cila u fokusua në krijimin e marrëdhënieve pozitive
  - Për të rriturit, mbështetja këshilluese ofroi mbështetje duke filluar nga përballja me humbjen dhe depresionin. Një grup mbështetës i prindërve promovoi marrëdhënie të qëndrueshme familjare duke ofruar një hapësirë të sigurt për prindërit për të diskutuar çështjet familjare dhe për të marrë këshilla në një mjedis jo gjykues
- QKSHF-ja rezultoi të ishte e aftë për të organizuar aktivitete ndërgjegjësuese në komunitet për çështje që variojnë nga ndërgjegjësimi për kancerin e gjirit dhe veprimi i komunitetit kundër DHBGJ.

## Ndikimi

- ✓ Përmirësimi i mirëqenies me përfituesit që raportuan shërbimet e QKSHF-së kishte rritur mbështetjen sociale që ata kishin dhe kishin përmirësuar qëndrueshmërinë e tyre përmes aftësive për jetën
- ✓ Të fokusuar në parandalimin ku ndërhyrja e hershme zvogëlon rreziqet për të rinjtë dhe familjet në rrezik dhe çon në rezultate më afatgjatë
- ✓ Shërbimi parandalues i përqendruar në familje është një model fleksibël i drejtuar nga komuniteti që është zhvilluar në Mallakastër dhe/ose përsëritet në bashkitë e tjera



### Një model për rritje dhe përsëritje

Ngritja e QKSHF-së në Mallakastër, në qytetin e Ballshit, ka rezultuar të jetë një nismë inovative dhe me ndikim të rëndësishëm për Bashkinë, duke prezantuar një model të ri të shërbimeve sociale të integruara. Ky model siguron që nevojat lokale të jenë në qendër të ofrimit të shërbimeve.

Modeli i QKSHF në Mallakastër përfaqëson një praktikë të suksesshme në sigurimin e përfshirjes sociale, planifikimit pjesëmarrës të shërbimeve dhe zhvillimit të qëndrueshëm lokal. Përmes përfshirjes aktive të komunitetit në çdo fazë, projekti QKSHF jo vetëm që ka ofruar shërbime, por ka ndikuar edhe në ndryshimin e perceptimeve, ndërtimin e besimit dhe nxitjen e ndryshimeve sociale afatgjata.

Projekti QKSHF në Mallakastër ka demonstruar me sukses një model të integruar dhe të bazuar në komunitet për ofrimin e shërbimeve, i cili është i orientuar drejt ndikimit dhe i shkallëzueshëm. Duke investuar në ndërtimin e kapaciteteve, bashkëpunimin, fuqizimin ekonomik dhe kujdesin social gjithëpërfshirës, projekti ka krijuar një model të qëndrueshëm dhe të suksesshëm, i cili mund të zhvillohet më tej në Mallakastër dhe të replikohet në bashki të tjera.

